



Deklarata e Arlintonit

MBI PËRKTHIMIN E BIBLËS

PARATHËNIE

Ne pohojmë se gjashtëdhjetë e gjashtë librat kanonikë të Biblës, origjinali i të cilave ishte shkruar në hebraisht, aramaisht dhe greqisht, janë Fjala e shkruar e Zotit. Si të tilla, dorëshkrimet origjinale janë pa lëshime, dhe të pagabueshme në gjithçka që pohojnë. Megjithëse dorëshkrimet origjinale ndoshta nuk ekzistojnë më, Fjala e Perëndisë është ruajtur jashtëzakonisht mirë në numrin e kopjeve që kemi qasje sot.

Ne pohojmë se për shkak se Bibla është Fjala e përsosur e Perëndisë dhe për shkak se Perëndia i krijoi të gjitha mendjet njerëzore, si dhe gjuhën, kuptimi i Fjalës së Perëndisë mund të shprehet me besnikëri në çdo gjuhë njerëzore përmes përkthimit të Biblës.

Ne pohojmë se strukturat gramatikore, si dhe vargu semantik i fjalëve ose frazave, ndryshojnë nga gjuha në gjuhë. Prandaj, përkthyesit duhet t'i kuptojnë këto dallime gjuhësore në mënyrë që të komunikojnë saktësisht të vërtetën e Perëndisë aq qartë, siç bënë edhe tekstet në gjuhën origjinale.

Ne pohojmë se Bibla i përket Zotit dhe se “gjen siguri në numrin e madh të këshilltarëve” (Fjalët e Urta 11:14). Prandaj, inkurajojmë organizatat e përkthimit dhe shoqëritë biblike që t'i bëjnë përkthimet e tyre lehtë të qasshme online, kurdo që të jetë e mundur, në mënyrë që të gjithë të përfitojnë nga puna e tyre dhe të ofrojnë një ndihmë të mirëfilltë për rishikime në të ardhshmen.

Ne pohojmë se puna ndriçuese e Frymës së Shenjtë është thelbësore për të kuptuar drejt Fjalën e Perëndisë (1 Korintasve 2:14). Për më tepër, Perëndia e ka bërë Kishën e Tij “shtylla dhe mbështetja e së vërtetës” (1 Timoteut 3:15). Prandaj, Perëndia i ka dhënë Kishës përgjegjësinë të sigurojë besnikëri në përkthimin e Fjalës së Tij. Që të dyja, si kisha globale edhe ajo lokale janë me vlerë, me njohuri relevante (siç është njohja e gjuhës burimore, gjuhën e receptorit apo njohuri teologjike) e cila është e dobishme në

prodhimin e përkthimeve besnike, pasi besimtarët punojnë me përlësi së bashku si një trup në unitetin e Frymës. Përkthimet duhet të bëhen në atë mënyrë që me besnikëri të shprehin vetë-zbulesën e Perëndisë, të nderojnë kongregacionet lokale të cilat do të përdorin përkthimin dhe të ruajnë lidhjen e paqes të Kishës globale.

Në dritën e pohimeve të mësipërme, propozojmë që parimet udhëzuese të mëposhtme të adresojnë disa nga praktikat problematike në disa prej përkthimeve të fundit të Biblës.

NENI 1

Përkthyesit nuk duhet të përkthejnë në atë mënyrë që pohon në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar teologjinë e feve të tjera në kurriz të kuptimit, kontekstit dhe implikimeve teologjike të teksteve në gjuhën origjinale.

- Për shembull, fjalët e para të shprehjes së besimit islam (لا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ “Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut / Perëndisë”) nuk duhet të përdoren në ndonjë përkthim biblik, sepse kjo është një frazë e qartë islamike që sjell kuptimin islam dhe konotacione që ndërhyjnë në një kuptim besnik të tekstit biblik. Për myslimanët, gjysma e parë e shprehjes islamike të besimit në mënyrë të natyrshme e thotë në mendje gjysmën e dytë, domethënë, “dhe Muhamedi është i dërguari i Allahut / Perëndisë”. Ajo gjithashtu mbart me vete konceptin absolut islamik të të vetmit Perëndi e që mohon në mënyrë të qartë Trinitetin. Në të kundërt, pohimet biblike të monoteizmit mësojnë se nuk ka Perëndi tjetër përveç Zotit - domethënë YHWH, Perëndia besnik i Izraelit, që është Ati, Biri dhe Fryma e Shenjtë (p.sh. 1 Mbretërve 18:39, Psalmi 18:31 , 1 Korintasve 8:4-6; Efesianëve 4:4-6).

NENI 2

Për shkak se çdo person në çdo kulturë duhet të njohë të vërtetën e Perëndisë në të gjithë plotësinë e tij, përkthimet biblike nuk duhet të shmangin përballjen me mëkatën ose gënjeshtren me të cilën përballen tekstet në gjuhën origjinale, qoftë mes besimtarëve apo jobesimtarëve.

- Për shembull, nëse ndonjë hindus ofendohet nga thirrja babait të djalit plangprishës, “Shpejt! Sillni viçin e majmur dhe thereni!” (Luka 15:22-23), përkthyesit nuk mund ta “rregullojnë” këtë pjesë sikur babai të bëjë vetëm një thirrje të përgjithshme për një festë dhe duke e eliminuar referencën për viçin. Nëse bëhet kjo atëherë do të hiqte një dëshmi e rëndësishme që Jezusi nuk e konsideronte therjen e gjedheve si mëkat, të cilin njerëzit duhet ta dinë në mënyrë që të mendojnë në mënyrë biblike.

- Po ashtu, edhe nëse adhuruesit e idhujve janë ofenduar nga polemika e fortë e Isaisë kundër idhujve në pasazhin siç është te Isaia 44:9-20, përkthyesit nuk duhet ta zbusin tonin e tij, sepse vetë toni është pjesë e mesazhit të frymëzuar nga Perëndia që idhujtaria është e neveritshme për Perëndinë.

NENI 3

Fryma e Shenjtë ka krijuar një sixhade të thurur në mënyrë të ndërlikuar të së vërtetës, që përmban një numër termash kyç të lidhura nëpër pasazhe të shumta që të gjithë kontribuojnë në kuptimin e tërësisë. Përkthyesit duhet të përpiqen për një shkallë të lartë konsistence në përkthimin e këtyre termave kyç në mënyrë që të ruajnë sa më shumë që të jetë e mundur kuptimin e gërshetuar në përkthim.

- Për shembull, fjala greke κύριος “Zot” nuk duhet të përkthehet ndryshe bazuar në faktin se përkthyesit përcaktojnë se a i referohet Perëndisë At apo Perëndisë Bir. Përkthimi i κύριος si “Allah / Perëndi” për Perëndinë At (p.sh. 1 Pjetrit 3:12; shiko Psalmin 34: 15-16), por si “Mjeshtër” ose “Zot” për Jezusin (p.sh. 1 Pjetrit 3:14-15; shih Isaia 8:12-13), errëson barazinë e Jezusit me Atin, sepse Ati dhe Biri janë në mënyrë të barabartë Mjeshtër, Zot e Perëndi.
- Po kështu, termi “Bir i Perëndisë” dhe termat “At” dhe “Bir” kur i referohen Perëndisë, duhet të përkthehen duke përdorur të njëjtat terma që zakonisht përdoren për të shprehur marrëdhënien njerëzore at-bir. Shtimi i cilësorëve në termat familjarë (si në “bir shpirtëror”) ose përdorimi i termave që nuk janë kryesisht familjarë (siç është “Mesia”, “i dashur”, “princi” ose “kujdestari”) në mënyrë të pashmangshme shkakton humbjen e kuptimeve hyjnore. Termat që shprehin drejtpërdrejt marrëdhënien njerëzore at-bir janë të domosdoshme që lexuesit të lidhin së bashku konceptet kryesore siç është Jezusi, trashëgimtari i vetëm natyror i mbretërisë së Perëndisë, duke shijuar një marrëdhënie unike me Atin, duke qenë shëmbëllesa i saktë i Atit dhe duke qenë i parëlinduri i çdo krijese (Mateu 21:37-38, Hebrenjve 1:2-3, Kolosianëve 1:13-18). Termat e tillë janë gjithashtu të domosdoshëm që lexuesit të kuptojnë birësimin tonë si fëmijë të Perëndisë (Gjoni 1:12-13, Romakëve 8:14-29; Galatasve 4:1-7), ofertën e Abrahamit për flijim Isakun (Zanafilla 22:1-18), shëmbëlltyrë e pronarëve të ligjë (Mateu 21:33-46, etj.), babai në shëmbëlltyrën e djalit plangprishës (Lluka 15:11-32) dhe shumë lidhje të tjera të rëndësishme në Shkrim. Keqkuptimet e mundshme mund të adresohen përmes mësimave të krishtera ose përmes një materiali paratextual, të tilla si prezantimet e librave, shënimeve ose një fjalor.

PËRFUNDIMI

Si përfundim, ne pohojmë se i tërë Shkrimi dhe të gjitha produktet e bazuara në Shkrimet e Shenjta duhet t'i përmbahen secilit prej parimeve të mësipërme. Deri në atë shkallë që nëse nuk janë përmbajtur atëherë ne kërkojmë që ato të korrigjohen.

Ne si nënshkrues përkushtohemi t'i ndjekim këto parime gjatë gjithë punës tonë gjatë përkthimit të Biblës, dhe u bëjmë thirrje të gjithë përkthyesve dhe organizatave të përkthimit të bëjnë të njëjtën gjë.